



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr.: **53/2024**

Data: **07.10.2024, ora 11:00**

Vendi: **Zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi
Anëtarët e KQZ-së: Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti,
Në takim ishin të Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik
pranishëm: **U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP:** Besnik Buzhala
Përkthyes: Jehona Cami
Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Procesverbali i mbledhjes së KQZ Nr.51 dhe 52/2024**
- 3. Aktivitetet e SKQZ**
- 4. Aktivitetet e Zyrës**
 - 4.1. Rekomandim për ndalimin e transferimit të mjeteve financiare nga Fondi, për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- 5. Raport i Këshillave të KQZ**
 - 5.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore
 - 5.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve për emërimin e dy anëtarëve të KKZ në komunat Obiliq dhe Ranilluk për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025
 - 5.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi zëvendësimit dhe emërimit të dy anëtarëve të KKZ në komunat Junik dhe Mitrovica e Veriut për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025



- 5.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i revokimit të emërimit të mandatit të dy anëtarëve të KKZ në komunat Suharekë dhe Kamenicë për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025
- 5.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i përfundimit të mandatit të një anëtari të KKZ në komunën e Obiliqit për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025

6. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi, e paraqiti agjendën e takimit e cila, pa vërejtje, sugjerime dhe ngjashëm, u miratua nga tetë vota për nga anëtarët prezentë në këtë takim.

Më pastaj, u miratuan procesverbalet me 8 vota për nga mbledhjet e KQZ, nr.51 dhe 52/2024.

2. Aktivitetet e SKQZ

Besnik Buzhala, ushtrues detyre i Drejtorit të SKQZ-së, tha se është bërë një raport rreth aktiviteteve të Sekretariatit lidhur me procesin e përgatitjes së zgjedhjeve që do të mbahen më 9 shkurt, 2025. Periudha e shërbimit votues dhe e regjistrimit ka filluar me 29 gusht dhe përfundojnë të dy këto procese, me 26 dhjetor. Deri më tani, tha z. Buzhala, janë 744 kërkesa për ndërrimin e QV, dhe se prej tyre, janë aprovuar 725, ndërsa janë refuzuar 19 kërkesa. Lidhur me periudhën e regjistrimit e votuesve jashtë Kosovës, deri dje, ja 6690 kërkesa. Prej tyre, 5571 janë aprovuar dhe 498 kërkesa janë refuzuar. Z. Buzhala, pasqyroi arsyet e refuzimit, dhe tha se të refuzuarave u janë dërguar imella në mënyrë që, ata ti shohin vërejtjet, t'i plotësojnë aplikimet sipas kriterëve që kërkohen për aplikim.

Gjithashtu, tha z. Buzhala, raporti përmban edhe të dhënat se si 1912 votues do të votojnë në mënyrë fizike në përfaqësitë diplomatike, 3008 aplikues përmes postës në kutinë postare jashtë Kosovës, dhe 651 votues do të votojnë përmes postës në kutinë postare në Kosovë. Z. Buzhala, pasqyroi edhe informacionet lidhur me shtetet prej nga votuesit kanë aplikuar për votim.

Në fund, ai e informoi KQZ-në edhe për programin oerientues për KKZ-të: mbarëvajtjen e tij nëpër qendrat regjionale.



3. Aktivitetet e Zyrës

Rekomandim për ndalimin e transferimit të mjeteve financiare nga Fondi, për subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës:

Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës, tha se është një rekomandim për zbritjen e buxhetit për gjordat e shqiptuara për subjektet politike. Zyra ka shqiptuar në korrik janë shqiptuar disa gjorda për subjektet parlamentare në Kuvend. Ato, kanë qenë të obliguara që për 30 ditë, ti paguajnë por nuk i kanë paguar. Prandaj, rekomandimi i zyrës është që shumat të ndalohen në pakon e buxhetit në kotat e shqiptuara.

Me 8 vota për, u miratua ky rekomandim.

4. Raport i Këshillave të KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve për emërimin e dy anëtarëve të KKZ në komunat Obiliq dhe Ranilluk për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar kërkesat lidhur me emërimin e dy anëtarëve të KKZ në komunat Obiliq dhe Ranilluk. Si këshill, rekomandojmë sepse, dy emërimet vijnë me vonesë. Bëhet fjalë për anëtarin Hasan Dubova nga komuna e Ranillukut, dhe Valon Sadikun në komunën e Obliqit. Të dy këta nga subjektet: AAK dhe PDK.

Rekomandojmë që të miratohen.

Anëtarët e KQZ të pranishëm në këtë mbledhje, me 8 vota miratua këtë rekomandim.

2. Shqyrtimi dhe miratimi zëvendësimit dhe emërimit të dy anëtarëve të KKZ në komunat Junik dhe Mitrovica e Veriut për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025:

Arianit Elshani, tha se është shqyrtuar edhe kërkesa për zëvendësimit dhe emërimit të dy anëtarëve të KKZ në komunat Junik dhe Mitrovica e Veriut. Kërkesat janë nga AAK dhe Gis-po. Rekomandojmë zëvendësimin.

Kreshnik Radoniqi: Bëhet fjalë për Burim Kuqin dhe Jasmina Dobovacin. Kush është për emërim...?

Anëtarët e KQZ, me 8 vota miratua këtë rekomandim.



3. Shqyrtimi dhe miratimi i revokimit të emërimit të mandatit të dy anëtarëve të KKZ në komunat Suharekë dhe Kamenicë për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025:

Arianit Elshani, tha se po ashtu është shqyrtuar edhe kërkesa e revokimit të emërimit të mandatit të dy anëtarëve të KKZ në komunat Suharekë dhe Kamenicë. Është konstatuar se këta dy, nuk janë paraqitur për dy ditë rresht në punë, dhe rekomandohet që atyre tu revokohet mandati.

Anëtarët e KQZ, me 8 vota miratua këtë rekomandim sipas të cilit, revokohet mandati i Bahtia Kryeziut nga IRDK në Suharekë dhe Kevin Shabani po ashtu nga IRDK në Kamenicë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i përfundimit të mandatit të një anëtari të KKZ në komunën e Obiliqit për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 9 shkurt 2025:

Arianit Elshani, në fund e informoi KQZ ka shqyrtuar përfundimin e mandatit të një anëtari të KKZ në komunën e Obiliqit. Bëhet fjalë për Goran Miliq nga GIS-po, i cili ka dhënë dorëheqje. Rekomandojmë që të miratohet dorëheqja e tij.

Me 8 vota për, miratohet ky rekomandim.

6. Të ndryshme!

